

Prishtinë, 15/11/2005
Kodi I ZRrE-s: D_04_2005

Zyra e Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_02_2005 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”;
4. Aplikacionin për tarifën e ngrohjes në sezonin 2005/2006 dorëzuar nga ana e Ndërmarrjes së Ngrohjes Qendrore (NNQ) Gjakovë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) më datë 5 shtator 2005;
5. Komentet për aplikacionin për tarifën e dhëna nga ana e ZRrE-së me datë 19 shtator 2005;
6. Aplikacionin për tarifën, të rishikuar, të NNQ Gjakovë dorëzuar me datë 23 shtator 2005;
7. Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NNQ Gjakovë për sezonin e ngrohjes 2005/2006, nxjerrë nga ana e ZRrE-së me datë 20 tetor 2005, shoqëruar nga ANNEX I “RAPORTI RREGULLATIV – Metodologjia dhe Rishqyrtimi i Çmimeve për Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NNQ Gjakovë, për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”.
8. Propozimin e tarifave dorëzuar nga ana e NNQ Gjakovë Zyrës së Rregullatorit për Energji më 8 nëntor 2005; letra nr. 845, e datës 2 nëntor 2005.

Ka vendosur që:

1. Të aprovojë tarifën për NNQ Gjakovë për tërë gjashtëmuajorin e sezonit të ngrohjes 2005/2006 siq është paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe llogaritja detale e paraqitur në ANNEX II i këtij vendimi “ RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i Tarifave për NNQ Gjakovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”.
2. Tarifën e aprovuar do të publikohen nga ana e NNQ Gjakovë në njërin nga gazetën kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) do të përdorë të drejtave sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat e paraqitura dhe faturat në të cilat është bazuar llogaritja e tarifave gjatë periudhës së ardhshme të ngrohjes.
4. Gjatë sezonit të ngrohjes 2005/2006 NNQ Gjakovë mund të paraqesë para Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimin për ndryshime të arsyeshme të tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja në pajtim me Udhëzimet e Përkohshme të datës I_02_2005 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006” nxjerrë me datë 10 gusht 2005.

5. NNQ Gjakovë ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.

**TARIFAT PËR NDËRMARRJEN E NGROHJES QENDRORE "GJAKOVA"
PËR SEZONIN E NGROHJES 2005/2006**

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PA-NJEHSUAR

NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "GJAKOVA"		
Komponentet e Tarifave	Amvisri	Komercial dhe Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 0.23 / m2 per muaj	€ 0.30 / m2 per muaj
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 0.62 / m2 per muaj	€ 0.96 / m2 per muaj

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR

NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "GJAKOVA"	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 2.42/ kW
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 45.97 / MWh

Inkurajojmë Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore që të matin konsumin e ngrohjes nëpër nënstacione sa më shumë që të jetë e mundur përmes njehsorëve të kalibruar të ngrohjes, posaçërisht për konsumatorët komercialë dhe institucionet.

Në emër të ZRrE-së

Dr. Nick F. Frydas
Kryesues i Bordit